



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
ZËVENDËSKRYETARI

Nr. 5795 prot.

Tiranë, më 28.10.2022

NJOFTIM

për rihapjen e procedurës së aplikimit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Bazuar në nenin 125, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton kompetencën e Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e tre anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në nenin 7/ç, pika 1 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 26, pika 2 të ligjit nr. 98/2018 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, kryetari i Gjykatës së Lartë, pas njoftimit të vendit vakant nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese, shpall hapjen e procedurës së aplikimit në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit.

Referuar njoftimit të bërë nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese për 1 (një) vend vakant me qëllim zëvendësimin e gjyqtarës zj. Vitore Tusha, kryetari i Gjykatës së Lartë ka shpallur njoftimin për plotësimin e kësaj vakance në datat: 16.01.2017, 19.04.2019, 03.06.2021 dhe 31.01.2022. Për shkak të numrit të pamjaftueshëm të kandidatëve Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk ka përfunduar procedurat e vlerësimit dhe të renditjes së kandidatëve nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Me shkresën nr. 612 prot, datë 19.10.2022, kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ka vënë në dijeni zëvendëskryetarin e Gjykatës së Lartë se “aktualisht në garë për plotësimin e kësaj vakance kanë mbetur 2 kandidatë, si dhe në respektim të parimit të konkurrencës së përzgjedhjes së më të mirit”, në mbledhjen e datës 29.09.2022, pasi vlerësoi dhe diskutoi situatën e krijuar në vakancën e zj. Vitore Tusha, vendosi t’i bëjë të ditur Gjykatës së Lartë situatën me qëllim vlerësimin e mundësisë së rishpalljes së thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për këtë vend vakant.

Bazuar në shkresën e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe pasi thirri Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve të kësaj Gjykate, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë vlerësoi se është e nevojshme rishpallja e thirrjes për plotësimin e vendit vakant të krijuar nga mbarimi i mandatit të gjyqtarit Gjykatës Kushtetuese, për pjesën e mbetur të mandatit 9 vjeçar, që përfundon në muajin mars 2025.

Afati i pranimit të kërkesave të kandidatëve është 30 ditë nga data e publikimit të njoftimit. Pas përfundimit të këtij afati, Gjykata e Lartë i përcjell Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët për vlerësimin e kushteve dhe kritereve të emërimit të tyre në Gjykatën Kushtetuese.

Kandidatët që konkurrojnë për mandatin e gjyqtarit kushtetues të zgjedhur nga Gjykata e Lartë duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton plotësimin e kushteve dhe kriterëve që parashikon neni 7/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, i ndryshuar, si vijon:

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriterë:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

- a) vjetërsisë në profesion;
- b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtuese a Gjykatës së Lartë;
- c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
- ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
- d) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimi përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
- dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

Lista e kandidatëve do të bëhet publike në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, me qëllim që institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë t'u jepet mundësia të paraqesin pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat.

ZËVENDËSKRYETARI

SOKOL SADUSHI

